



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.251/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Venera Kabashi nga Zvicra, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën e votuesve, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet si palejuar apeli Anr.251/2017 e datës 12.06.2017, e parashtruar nga Venera Kabashi nga Zvicra.

A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një apel nga Venera Kabashi nga Zvicra, të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 31.05.2017 në të cilën pretendohet se nuk figuron në Listën e shpallur nga KQZ-ja, për votim jashtë vendit, edhe pse disa herë ka tentuar që përmes email-it kopjen e pasaportës por nuk ka arritur në emailin zyrtar të KQZ-së për shkak të ngarkesës së emailit. Parshtruesja e ankesës thekson se është ankuar me email por nuk kishte pranuar përgjigje nga KQZ-ja. Parashtruesja e apelit në cilësi të provës ka bashkangjitur korrespondencat përmes emailit të KQZ-së.

Në përgjigjen në ankesë të datës 13.06.2017, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve-KQZ, thekson se në rastin konkret parashtruesja e ankesës përveç formularit për aplikimit, votuesja nuk ka dërguar kopje të dokumentit identifikues, ashtu siç është paraqitur në korrespondencat përmes emailit, por një gjë të tillë nuk e kemi pranuar.

PZAP-i gjeti se apeli është i palejuar:

PZAP-i, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i palejuar sepse KQZ-ja gjatë periudhës së përgatitjes së Listës Votuese Jashtë Kosove për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017, ka pranuar një kërkesë për regjistrim përmes email mirëpo nuk kanë plotësuar kriteret për të qenë pjesë e listës.

Andaj, mbi këtë bazë paneli vlerëson se pretendimet ankimore të parashtrueses së apelit nuk qëndrojnë për faktin se KQZ-ja, afatin për miratimin e Listës Votuese Jashtë Kosove e ka pasur më 1qershor 2017 për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017. Andaj me këtë rast paneli konstaton se apeli në këtë fazë është e palejuar për tu parashtruar, sepse PZAP-i vendos në kuptim të dispozitës të nenit 122.1 i LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lart e në mbështetje të dispozitës së nenit 118 par.1 të LZP-së, dhe nenit 6 par.4 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 251/2017 më datën 13.06.2017.



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.